


**WILLKOMMEN
BAINVEGNI
BENVENUTI**

Informacione për të ardhur të rinj



INFORMACIONE PËR TË ARDHUR TË RINJ

Zyra e Integrimit

www.integration.gr.ch

www.hallo.gr.ch

PËRMBAJTJA

1	Allegra, Grüezi, Buongiorno	9
2	Informacione për Zvicrën Histori e shkurtër dhe njohuri për shtetin	10
3	Informacione për kantonin Graubünden Shifra dhe fakte	12
4	Shumëllojshmëri gjuhësh në kantonin Graubünden	14
5	Integrimi Qendra e Informacionit për Integrimin Graubünden Platforma shumëgjuhëshe e informacionit www.hallo.gr.ch	17
6	Komunikimi Gjuha, çelësi për integrimin e suksesshëm! Ndërmjetësim përkthyesish	18
7	Puna Integrimi profesional Paga dhe kontributet sociale Kërkim për vende pune I papunë – po tani? Punë e zezë Formime profesionale dhe kualifikime të mëtejshme Njohja e diplomave të huaja	20
8	Leja e qëndrimit dhe bashkimi familjar	24

9**Martesa dhe familja****25**

Martesa

Çifte binacionele dhe familjet

Partneritete të regjistruar

Martesë e detyruar

Lindja

Leja e lindjes dhe shpërblimi

Shtesat familjare

10**Fëmijët****28**

Rritja me shumë gjuhë

Këshillimi i prindërve

Aplikacione për familjet dhe prindërit

Huamarrja e librave dhe lojërave

Mundësi përkujdesjesh

Telefon emergjent për prindërit

11**Shkolla dhe formimi profesional****30**

Përgjegjësia e prindërve

Këshillime falas për të rinjtë

Shkollat e mëtejshme dhe formimi profesional

Oferta mbi zgjidhjet e ndërmjetme

Të rinj të emigruar vonë

Gjimnaze, shkolla të mesme tregtare dhe profesionale

Mësimi i profesionit

Maturë profesionale

Formimi profesional dhe kualifikimi i mëtejshëm

Shkollat e larta profesionale

Shërbimi psikologjik shkollor

Psikiatri për fëmijë dhe të rinj Graubünden

Dhuna ndaj fëmijëve

12	Banimi	35
	Shpallje për banesa	
	Vendi i këshillimit për të drejtën e qirasë	
<hr/>		
13	Shëndeti	38
	Adresa të mjekëve dhe mjekëve	
	Sëmundje ose aksidente	
	Spitali	
	Këshillim dhe përkujdesje në shtëpi	
	Persona të moshuar	
	Njerëz me aftësi të kufizuara	
	Njerëz me probleme psikike	
<hr/>		
14	Sigurimet	40
	Sigurime të detyrueshme	
	Sigurimi bazë shëndetësor	
	Ulja e premies për sigurimin shëndetësor	
	Sigurimi ndaj aksidenteve	
	Sigurime vullnetare	
<hr/>		
15	Taksat	42
<hr/>		
16	Këshilla sociale dhe ndihma sociale	43
	Këshilla sociale personale	
	Ndihmë sociale financiare	
<hr/>		
17	Jeta e përditshme - takime	44
	Jeta e lagjes/e fshatit	
	Shoqata dhe klube	
	Shoqata të huajsh	
	Muzeume, teatro dhe kinema	
	Blerja	
	Bankat	

Ditët e festave
Ekskursionë dhe koha e lirë

18 **Mobiliteti** **47**

Mjetet publike të qarkullimit (ÖV): Tren dhe autobus
Drejtimi i automjetit në Zvicër
Bicikleta

19 **Mjedisi** **50**

Mbroni mjedisin!
Mbeturinat
Uji i pijshëm

20 **Adresa dhe link-e të dobishme** **52**

Brenga të jetës së përditshme
Puna
Diskriminimi/racizmi
Familje dhe partneritet
Financat
Shëndeti
Dhuna/ndihma për viktimat
Integrimi/Migracioni
Përkthimi ndërkulturor
Fëmijë dhe të rinj
Mediat e popullsisë migrante
Shërbime sociale
Shkolla për gjuhën
E drejta

21 **Rast emergjent, si veprohet?** **64**

Dëftues botimi **66**



ALLEGRA, GRÜEZI, BUONGIORNO

Të dashur të sapoardhura dhe të sapoardhur

Në emër të qeverisë Bündner ju uroj mirëseardhjen e përzemërt në kantonin tonë!

Me marrjen tuaj të vendbanimit në kantonin tonë, ju tani jeni pjesë e shoqërisë sonë të larmishme, e cila është e përbërë nga grupe të shumta të popullsisë. Këto ndryshojnë jo vetëm për sa i përket gjuhës, origjinës dhe traditave, por edhe lidhur me moshën, profesionin, interesat dhe shumë më tepër. Të jetuarit në shumëllojshmëri është përditshmëri në Graubünden dhe sjell me vete si shanse ashtu edhe sfida.

Graubünden është i shumanshëm dhe ka shumë për t'ju ofruar. Kështu topografia jonë është e karakterizuar nga 150 lugina, 615 liqene, 937 maja malore. Gjuhët tona zyrtare janë gjermanisht, retoromanisht dhe italisht. A e keni ditur se retoromanishtja flitet në Zvicër vetëm në Graubünden dhe se nuk është vetëm një gjuhë, por një familje prej pesë idiomash: Sursilvan, Sutsilvan, Surmiran, Puter dhe Vallader? Ne jemi krenarë për traditat dhe zakonet tona të vjetra qindravjeçare, njëkohësisht jemi të ankoruar në të tashmen moderne dhe dëshirojmë të krijojmë së bashku me ju të ardhmen tonë shoqërore.

Shumë inisiativa dhe projekte në kanton - ndër të tjera edhe oferta të shumta të nxitjes së integrimit - angazhohen për forcimin e lidhjes shoqërore. Bashkimi bën fuqinë dhe në këtë kuptim ne ju ftojme të merrni pjesë në jetën tonë shoqërore, ekonomike dhe kulturore.


Informohuni pranë komunës ku banoni ose në zyrën e specializuar kantonale për integrim mbi ofertat ekzistuese të informimit, këshillimit dhe kurseve. Shfrytëzoni ato dhe përfitoni nga mundësitë që lindin prej tyre.

Ne ju urojmë një fillim të mbarë në atdheun tuaj të ri.

Peter Peyer

Këshilltari qeveritar

INFORMACIONE PËR ZVICRËN



Në shifra (2019)

Numri i banorëve	8 606 000
Nënshtetas të huaj	25.3 %
Sipërfaqja	41 300 km ²
Kantone	26

Histori e shkurtër dhe njohuri për shtetin

Më 1 gusht 1291 u krijua «Konfederata e Vjetër» prej vendeve Uri, Schwyz dhe Unterwalden si një besëlidhje e lirë e bashkësive të luginave. Më pas asaj ju bashkuan vende dhe rajone të tjera. Kështu u krijua më 1848 shteti federal modern i Zvicrës. 1 gushti është dita e festës kombëtare të Zvicrës.

Zvicra është një demokraci direkte, në të cilën gratë dhe burrat me të drejtën e votës, jo vetëm nëpërmjet zgjedhjeve, por edhe të referendumeve të shpeshta mbi ligje dhe pyetje specifike, mund të japin ndikim të drejtpërdrejtë në politikë. E drejta e bashkëvendosjes qëndron në nivel federate, kantoni dhe komune. Të drejtën në shkallë kombëtare të zgjedhjes dhe votës zviceranet dhe zviceranët e marrin në moshën 18 vjeç.

Gjuha(ët) kryesore

61.2 %
gjermanisht

22.3 %
frëngjisht

8.0 %
italisht

0.5 %
retoromanisht

23.8 %
gjuhë të tjera

(BFS 2017)

Ju gjeni informacione të tjera për shtetin në broshurën «Echo». Porositet në të gjitha vendet për tregtimet e librit ose tek

HEKS, Regionalstelle Ostschweiz

☎ 071 410 16 84

www.echo-ch.ch

INFORMACIONE PËR KANTONIN GRAUBÜNDEN



Shifra und fakte (2019)

Në kantonin Graubünden jetojnë mbi 199'000 banore dhe banorë. Prej këtyre zotërojnë rreth 37'300 persona një nënshtetësi të huaj. Me 7106 km² Graubünden është kanton i më i madh në Zvicër dhe përfaqëson 1/6 e territorit zviceran. Rreth 35'400 persona jetojnë në kryeq-

tetin Chur, një nga ngujimet më të vjetra të Zvicrës.

Kantoni është i ndarë në 11 rajone dhe 106 komuna. 50 % të komunave kanë më pak se 1000 banore dhe banorë.




Numri i luginave 150

Numri i liqeneve 615

Numri i majave të maleve 937

Informacione të mëtejshme ju gjeni në www.gr.ch

SHUMËLLOJSHMËRI GJUHËSH NË KANTONIN GRAUBÜNDEN



Gjuhët e kantonit Graubünden

- gjermanisht
- retoromanisht
- italisht

Në kantonin Graubünden ka tre gjuhë zyrtare: gjermanisht, retoromanisht dhe italisht.

Gjermanisht

Për banoret dhe banorët më të shumtë të kantonit gjuha amtare është gjermanishtja, që do të thotë, ata shkruajnë gjermanishten letrare dhe flasin gjermanishten zvicerane.

Retoromanisht

Në Engadin, në Münstertal, në Mittelbünden dhe në Surselva gjuha standarde është retoromanishtja. Por retoromanishtja nuk është vetëm një gjuhë, por një familje prej 5 idiomash. Sursilvan, Sutsilvan, Surmiran, Puter dhe Vallader.

Italisht

Në katër luginat Puschlav, Bergell, Misox dhe Calanca flitet italisht.



INTEGRIMI

Integrimi është një proces dinamik, individual dhe shoqëror, i cili mbështetet në reciprocitetin e detyrave dhe të të drejtave dhe ka për qëllim të mundësojë pjesëmarrjen në jetën ekonomike dhe shoqërore për të gjitha grupet e popullsisë. Nxitja e integrimit i përmbahet principit «nxit dhe kërk» dhe mbështet në veçanti mësimin e gjuhës, përparimin profesional dhe pjesëmarrjen në jetën sociale.

Zyra e Integrimit drejton dhe koordinon nxitjen specifike për integrim në nivel kantonial dhe komunal. Ajo nxit dhe mbështet projekte për integrimin gjuhësor dhe social dhe siguron ndërmjetësimin e informacioneve në fushën e integrimit.

Fachstelle Integration Graubünden (Zyra e Integrimit)

☎ 081 257 26 38

www.integration.gr.ch

Qendra e informacionit për integrimin Graubünden

Në hapësirat e zyrës së specializuar për integrim në Grabenstrasse 1 në Chur gjendet qendra e informacionit për integrimin, e cila ofron

shërbimet që vijojnë:

- Ndërmjetësim informacionesh dhe këshillime të thjeshta për tema dhe pyetje me rëndësi për integrimin
- Pasqyrimine ofertave ekzistuese për mësimin e gjuhës dhe integrimin në kanton.
- Këshillim personal dhe individual për gjuhën me mundësinë që të bëhet një testim gjuhësor për klasifikim.

Informationszentrum Integration Graubünden (Qendra e informacionit për integrimin)

☎ 081 257 36 83

Të dhëna në lidhje me oraret e hapjes ju gjeni në www.integration.gr.ch

Në faqen shumë gjuhësore të internetit www.hallo.gr.ch Ju mund të gjeni informata të dobishme mbi temat e përditshme si jeta në Graubünden, puna, shkolla, shëndeti dhe banimi.

www.hallo.gr.ch



KOMUNIKIMI

Gjuha, çelësi për integrimin e suksesshëm!

Ju doni që në vendin tuaj të ri të banimit të merrni pjesë aktive dhe me të drejta të barabarta në jetën ekonomike, kulturore dhe sociale? Njohuri të mira të gjuhës lokale ju hapin juve dyert për këtë. Vizitoni një kurs gjuhësor dhe shfrytëzoni aplikacionet për mësimin e gjuhës, që të mund të komunikoni mirë në jetën e përditshme.

Në kapitullin «Adresa dhe linke të dobishme» ju gjeni një listë të shkollave për mësimin e gjuhës në kanton. Faqja e internetit www.integration.gr.ch ofron, përveç kësaj, një pasqyrim të ofertave ekzistuese të kurseve të gjuhës. Për informacione shtesë për mësimin e gjuhës ose për një këshillim personal juhe ju mund t'ju drejtoheni qendrës së informacionit për integrim.

Informationszentrum Integration Graubünden (Qendra e informacionit për integrimin)

☎ 081 257 36 83

Të dhëna në lidhje me oraret e hapjes
ju gjeni në www.integration.gr.ch

Ndërmjetësim përkthyesish

Mësimi i gjuhës lokale është i rëndësishëm. Por, duke pasur parasysh

që të kuptohen mirë bisedat dhe kuvendimet e rëndësishme, mund të jetë e nevojshme dhe ndihmuese që të thirret për ndihmë një përkthyes ndërkulturore respektivisht një përkthyes ndërkulturore.

Arge Verdi – Interkulturelles Dolmetschen in der Ostschweiz ndërmjetëson përkthyes profesionistë ndërkulturore në rreth 60 gjuhë. Ky shërbim është me pagese.

Arge Verdi – Interkulturelles Dolmetschen in der Ostschweiz (Përkthime ndërkulturore në Zvicrën e lindjes)

☎ 0848 28 33 90

www.arge.ch/verdi

Shërbimi nacional për përkthime me telefon brenda pak minutave ju vë në dispozicion përkthyes dhe përkthyes profesional për më tepër se 50 gjuhë. Gjatë 24 orëve, 365 ditë në vit. Ky shërbim është me pagesë.

Shërbimi nacional për përkthime me telefon

☎ 0842 442 442

www.0842-442-442.ch

PUNA

Të punosh atje, ku të tjerët bëjnë pushime!

Internacionaliteti ka traditë në Graubünden. Turizmi si degë dominuese e ekonomisë, shërbimi shëndetësor, ndërmarrje të vogla dhe të mesme, firma të shumta nacionale dhe internacionale si dhe administrata kantonale ofrojnë një numër të madh vendesh atraktive pune në fushat më të ndryshme profesionale.

Integrimi profesional

Puna siguron bazën e ekzistencës dhe nxit integrimin në shoqëri. Kusht paraprak për të hyrë në tregun e punës është një lejë për punë si dhe njohuri të mira të gjuhës lokale. Në faqet e mëposhtme të internetit ju gjeni informacione për lejet e nevojshme për punë dhe për zënien e vendit të punës.

www.kiga.gr.ch
www.afm.gr.ch
www.sem.admin.ch
www.swissuni.ch
www.berufsberatung.ch
www.migraweb.ch

Paga dhe kontributet sociale

Nga paga hiqen kontributet e detyrueshme për sigurimin e pleqërisë dhe të trashëgimtarëve (AHV – shtylla 1), sigurimin për invaliditet (IV), sigurimin për papunësi (ALV) dhe për sigurimin ndaj aksidenteve. Nga të ardhura vjetore prej rreth CHF 20'000 hiqen kontribute shtesë për përkujdesjen profesionale (të ashtu- quajturën shtylla 2) si një plotësim i AHV. Sigurimet e detyrueshme sociale përbëjnë gjithsej rreth 15 % të të ardhurave.

Kërkim për vende pune

Shpallje vendesh pune mund të shihen në qendrat rajonale për ndërmjetësim pune (RAV) dhe gjenden në gazetatat ditore, rajonale ose njoftues të qytetit, në «zyrat e përkohshme» si dhe në internet, si për shembull nën

www.arbeit.swiss
www.suedostschweizjobs.ch
www.jobs.ch

I papunë – po tani?

Kush banon në Zvicër dhe si punëmarrës ose punëmarrëse mbetet pa punë, ka të drejtë - në rast

se kushtet e nevojshme paraprake janë të përmbushura – për pagesën ditore të papunësisë. Kushtet thelbësore për këtë janë, një lejë qëndrimi dhe një zënie 12 mujore me punë në dy vjet para humbjes së vendit të punës.

Për pyetje në lidhje me papunësinë ju qëndrojnë juve në dispozicion, zyrat e arkave të papunësisë dhe qendrat rajonale për ndërmjetësim pune (RAV).

Në rast të humbjes së vendit të punës ose të kërcënimit prej papunësisë është e rëndësishme si më poshtë:

- Filloni menjëherë kërkimin e një vendi të ri pune, nëse ju nuk keni filluar tanimë. Këto përpjekje duhet të vërtetohen gjatë të drejtës për marrjen e të hollave ditore të sigurimit për papunësisë. Të ruhen shënimet përkatëse dhe kopjet e kërkesave me shkrim dhe shkresave refuzuese.
- Njoftohuni menjëherë tek zyra e punës e komunës suaj të banimit.

Informacione të mëtejshme ju gjeni nën

www.kiga.gr.ch oder
www.arbeit.swiss

Punë e zezë

Edhe dikush, i cili për punë të herë-pashershme në fushën e pastrimit, kujdesit të fëmijëve, për punët në kopsht ose në shtëpi paguhet, vlen si i zënë me punë dhe duhet të jetë nga një anë në zotërim të një leje policore për të huajt dhe nga ana tjetër të regjistrohet tek sigurimi social respektivisht të regjistrohet vetë. Nuk ndodh kjo, bëhet fjalë për një punë ilegale ose punë të zezë dhe personi në fjalë nuk është i siguruar në rast papunësie, aksidenti ose invaliditeti.

**Staatssekretariat für Wirtschaft
SECO (Sekretariati i Shtetit për
Ekonominë)**

☎ 058 462 56 56

www.keine-schwarzarbeit.ch

Formime profesionale dhe kualifikime të mëtejshme

Në qendrat rajonale të informacioneve për profesion (BIZ) ka informacione të shumëllojshme për formimin profesional dhe kualifikim të mëtejshëm. Për informime dhe biseda të shkurtra ju qëndrojnë në dispozicion persona të specializuar. Një vizitë është falas dhe gjatë

orarit të hapjes është e mundur të shkoni pa lajmërim. Për një këshillim personal për karrierë, i cili është me detyrim pagese, duhet të caktohet një orar.

Informacione të mëtejshme për këshillimin për profesionin, studimin dhe karrierën si dhe për qendrat rajonale të informacioneve për profesion (BIZ) ju gjeni nën

**Amt für Berufsbildung Graubünden
(Zyra për formimin profesional)**

☎ 081 257 27 68

www.berufsbildung.gr.ch

Njohja e diplomave të huaja

Për njohjen e diplomave të cilat janë përfituar jashtë shtetit është përgjegjës Sekretariati i Shtetit për Arsim, Kërkim dhe Novacion. Nëse ju dispononi një përvojë të

**Staatssekretariat für Bildung,
Forschung und Innovation SBFI
(Sekretariati i Shtetit për Arsim,
Kërkim dhe Novacion)**

☎ 058 462 28 26

www.sbf.admin.ch

gjatë profesionale, nën kushte paraprake të caktuara, ju mund ta

vini në provë përvojën tuaj dhe të përfitoni një diplomë të një profesioni të njohur në Zvicër.

**Amt für Berufsbildung Graubünden
(Zyra e Formimit Profesional)**

☎ 081 257 27 68

www.berufsbildung.gr.ch

Për njohjen e diplomave të shkollave të larta

**Rektorenkonferenz der Schweizerischen
Hochschulen (Konferenca e
Rektorëve të Universiteteve
Zvicerane)**

☎ 031 335 07 40

www.swissuniversities.ch



LEJA E QËNDRIMIT DHE BASHKIMI FAMILJAR

Leja e qëndrimit për nënshtetas të Bashkimit Evropian (EU)/Asociacionit Evropian të Tregut të Lirë (EFTA) mund të parashtrohet si para ashtu edhe pas hyrjes. Leje qëndrimi për nënshtetas të zënë me punë të vendeve të treta (nënshtetas të shteteve, të cilët nuk janë anëtarë të EU/EFTA) jepen vetëm në raste përjashtuese. Kjo do të thotë, nëse bëhet fjalë për forca të kualifikuara pune ose nëse shkaqe të veçanta e justifikojnë përjashtimin.

Nënshtetas të EU/EFTA, si rregull, pavarësisht nga lloji i lejes së qëndrimit, mund të tërheqin familjet e tyre. Si pjesëtarë të familjes vlejnë prindërit dhe fëmijët. Persona nga shtete të treta, të cilët janë në zotërim të një leje qëndrimi, nën marrjen parasysh të kushteve paraprake ligjore, mund të dorëzojnë një kërkesë për bashkim familjar (me bashkëshorten/in respektivisht me bashkëshorten/in dhe fëmijët) tek Zyra për Migracionin dhe të Drejtën Civile (Amt für Migration und Zivilrecht). Kërkesa për tërheqjen e familjes duhet të dorëzohet brenda 5 vjetësh dhe për fëmijët mbi 12 vjet brenda një viti.

Në Zyrën për Migracionin dhe të Drejtën Civile në Graubünden (Amt für Migration und Zivilrecht Graubünden) ose në faqen e saj të internetit ka fletëshpjegime në gjermanisht dhe italisht me informacionet më të rëndësishme për miratimin e qëndrimit dhe tërheqjen e familjes.

**Amt für Migration und Zivilrecht
Graubünden AFM (Zyra për Migracionin dhe të Drejtën Civile)**

☎ 081 257 30 01

www.afm.gr.ch

MARTESA DHE FAMILJA

Martesa

Në Zvicër secili duhet të jetë 18 vjeç, që të mund të martohet. Këtu njihen vetëm martesat, të cilat janë lidhur në një zyrë të gjendjes civile. Zyra e Gjendjes Civile e vendbanimit tuaj ju informon mbi kushtet para-prake që duhet të përmbushen dhe për dokumentet e nevojshme.

Çifte binacionale dhe familjet

Çdo martesë e tretë në Zvicër është një lidhje binacionale martesë. Në faqen e internetit www.binational.ch merren përgjigje mbi pyetjet, me të cilat janë të konfrontuar çiftet binacionale dhe familjet.

www.binational.ch

Partneritete të regjistruar

Çifte me gjini të njëjtë kanë mundësinë të regjistrojnë partneritetin e tyre. Zyra e Gjendjes Civile e vendbanimit tuaj ju informon juve mbi hapat që duhet të merren.

Martesë e detyruar

Në Zvicër vlen e drejta e zgjedhjes së lirë të partnerit respektivisht të partneres. Familjet ose persona të tjerë sipas kësaj nuk kanë të drejtë,

të detyrojnë gratë ose burrat të martohen kundër dëshirës së tyre.

Fachstelle Zwangsheirat (Vendi i specializuar për martesat e detyruara)

☎ 0800 800 007 (Linja falas e ndihmës)

www.zwangsheirat.ch

Lindja

Çdo lindje duhet t'i njoftohet zyrës përkatëse të gjendjes civile të vendbanimit tuaj. Lindet fëmija në një spital, kështu e njofton spitali lindjen. Gjatë një lindjeje në shtëpi është mamia e detyruar ta njoftojë fëmijën.

Leja e lindjes dhe shpërblimi

Të drejtën për shpërblim lind-jeje e kanë gratë, të cilat në kohën e lindjes së fëmijës janë të punësuara. Kusht për këtë është, që ato gjatë 9 muajve para lindjes së fëmijës të kenë qenë të siguruara dhe në këtë kohë, gjatë të paktën 5 muajve, të kenë qenë të punësuara. E drejta fillon ditën e lindjes dhe përfundon më së voni pas 14 javësh. Në këtë kohë paguhet deri në 80 % e pagës, por më së larti 196,- franga zvicerane në ditë.

Sozialversicherungsanstalt des Kantons Graubünden SVA (Enti i Sigurimit Social)

☎ 081 257 41 11
www.sva.gr.ch

muaj. Si rregull shtesën familjare e transferon punëdhënësi me pagën. Nën rrethana të caktuara mund të tërheqin edhe prindër jo të zënë me punë shtesa për fëmijë.

Sozialversicherungsanstalt des Kantons Graubünden SVA (Enti i Sigurimit Social)

☎ 081 257 41 11
www.sva.gr.ch

Shtesat familjare

Punëmarrëse dhe punëmarrës kanë të drejtë për shtesa familjare. Për fëmijë deri në përfundim të vitit të 16-të të jetës, shtesa mujore për fëmijët është 220,- franga zvicerane. Për të rinj në formim profesioni, maksimalisht deri në përfundim të vitit të 25-të të jetës, shtesa për formimin e profesionit është 270,- franga zvicerane çdo



MADE
ENVIRONMENTALLY
FRIENDLY
TRADE
MARK

FËMIJËT

Rritja me shumë gjuhë

Një fëmijë mund të mësojë dy ose më shumë gjuhë që nga lindja. Në këshilluesin për prindër «Fol me mua dhe më dëgjo me vëmendje!» ju gjeni këshilla, si mund ta nxisni fëmijën tuaj në zhvillimin shumëgjuhësh. Fletëpalosja është në dispozicion në 14 gjuhë. Ajo mund të porositet falas tek

Fachstelle Integration Graubünden (Zyra e Integrimit Graubünden)

☎ 081 257 26 38

www.integration.gr.ch

Këshillimi i prindërve Graubünden

Prindërit e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël mund t'i drejtohen këshillimit për prindërit. Ju merrni atje mbështetje në rast të pyetjeve në lidhje me ushqimin, shërbimin, përkujdesen dhe edukimin. Edhe nëse fëmija juaj bërtet shpesh ose nuk është i qetë, ju merrni ndihmë. Për këtë mund të shkoni në një qendër këshillimi. Këshilltaret e prindërve ju vizitojnë juve, nëse keni dëshirë, edhe në shtëpi ose ju japin informacione në telefon ose në linjë (online).

Informacione për ofertat e kës-

hillimit në rajonin tuaj i merrni në komunën tuaj të banimit.

Aplikacione familjesh dhe prindërisht

Ka shumë aplikacione praktike që mbështesin prindërit në fusha të ndryshme në jetën e përditshme familjare. Disa prej tyre janë shumëgjuhëshe dhe falas.

Parentu – Këshilla për prindër të fëmijëve ndërmjet 0 dhe 16 vjeç

Kleine Weltentdecker (Eksploruesit e vegjël të botës) – Këshilla për prindër të fëmijëve të vegjël

Erste Hilfe (SRK) Ndihma e parë – për situata emergjente

Huamarrja e librave dhe lojërave

Në vende të ndryshme në kanton ka biblioteka (libra) dhe ludoteka (sende për të luajtur). Për një kuotë financiare atje mund të merren hua libra dhe sende për të luajtur. Informata mbi këtë mund të merrni në komunën ku banoni.

Biblioteka e qytetit në Chur ofron një gamë të gjerë të mediave në gjuhë të huaja. Ajo është e hapur gjithashtu mbrëmjeve dhe në fundjavë.

Oferta përkujdesjesh (oferta me detyrim pagese)

Grup loje

Në grupin e lojës takohen fëmijë, që prej moshës tre vjet deri në hyrjen për në kopsht, një deri dy herë në javë. Grupi i lojës i ofron fëmijës një kornizë të sigurt dhe të kapshme me një vështrim, në të cilën ai mund të grumbullojë përvojat e tij të para jashtë familjes. Informacione për këtë ju merrni në komunën e vendbanimit tuaj.

Çerdhe fëmijësh dhe prindër ditorë

Çerdhja e fëmijëve kujdeset gjatë ditës për fëmijët deri në hyrje në kopsht. Informacione për ofertat e çerdheve të fëmijëve ju i merrni në komunën e vendbanimit tuaj ose tek

famur - für Familien in Graubünden (për familjet në Graubünden)

☎ 081 300 11 40
www.famur.ch

Për fëmijët po ashtu mund të përkujdesen prindër ditorë. Familja ditore mban nën kujdes fëmijë të çdo moshe – edhe fëmijë shkolle – tek ajo në shtëpi. Kohët e përkujdesjes (dreka, ndihma për detyrat,

kujdesi gjysmëditor, ditor ose javor) caktohen individualisht.

Oferta jashtëshkollore

Në rast pyetjesh për oferta si streha e fëmijëve, dreka në shkollë ose aktivitete gjatë kohës së pushimeve ju mund t'ju drejtoheni drejtuesve të shkollës suaj ose zyrës përkatëse kantonale.

Amt für Volksschule und Sport **Graubünden AVS (Zyra e Arsimit dhe Sportit)**

☎ 081 257 27 36
www.av.s.gr.ch

Telefon emergjent për prindërit

Edukimi i fëmijëve është shpesh për prindërit një sfidë e madhe. Telefoni emergjent për prindërit ofron përgjatë 24 orësh këshilla dhe ndihmë falas nëpërmjet telefonit ose e-mailit në rast të pyetjeve për edukimin, rastet e konflikteve ose krizave në familje.

Elternnotruf Graubünden

☎ 0848 35 45 55 (Tarifa e rrjetit fikso)
www.elternnotruf.ch

SHKOLLA DHE FORMIMI PROFESIONAL

Në Zvicër sistemet e shkollave ndryshojnë nga kantoni në kanton. Në kantonin Graubünden shkolla është që nga mosha 7-të deri në 16-vjeç e detyrueshme dhe falas.

Kopshti i fëmijëve

Që në moshën pesë vjeç fëmijët shkojnë në kopshtin e fëmijëve. Ai zgjat dy vjet.

Detyrimi për shkollë

Detyrimi për shkollë fillon në atë vit, në të cilin fëmija bëhet 7 vjeç, dhe zgjat nëntë vjet.

Sistemi i shkollës në kantonin Graubünden!

Kopshti i fëmijëve		2 vjet
Shkalla fillore	Shkolla fillore	6 vjet
Shkalla sekondare I	Shkolla sekondare, shkolla reale	3 vjet
Shkalla sekondare II	Vullnetarisht viti i 10-të i shkollës në gjimnaz, shkolla e mesme profesionale, mësimi i profesionit/formimi profesional në ndërmarrjen ku mësohet, shkolla e pjekurisë profesionale	2 - 5 vjet
Shkalla e tretë	Shkolla e lartë e specializuar Shkolla e lartë profesionale Universitet, ETH (Shkolla e lartë teknike konfederative)	3 - 6 vjet

Informacione për të gjitha temat e shkollës ju merrni në shkollat ose tek

**Amt für Volksschule und Sport
Graubünden AVS (Zyra e Arsimit
dhe Sportit)**

☎ 081 257 27 36

www.av.s.gr.ch



BWS

SCHRITT TEMPO

SCHRITT

Përgjegjësia e prindërve

Prindërit janë përgjegjës për edukimin dhe formimin e plotë të fëmijëve të tyre. Ata janë të detyruar, t'i regjistrojnë fëmijët në shkollë dhe të kujdesen për këtë, që ata të zbatojnë vajtjen në shkollë, planin e orëve dhe rregullin e shkollës. Po ashtu ata duhet të sigurojnë, që fëmijët të kryejnë detyrat e shtëpisë dhe t'u qëndrojnë në dispozicion për sigurimin e kushteve të përgjithshme të nevojshme për to. Bashkëpunimi ndërmjet shkollës dhe prindërve ka në Zvicër një domethënie qendrore. Prindërit ftohen nga shkolla rregullisht për biseda me prindërit dhe mbërmeje me prindërit. Pjesëmarrja është për prindërit dhe fëmijët e rëndësishme, për të gjetur zgjidhjet më të mira të mundshme për problemet në shkollë ose për zgjedhjen e duhur të profesionit.

Këshillime falas për të rinjtë

Këshilltarë/e për profesionin, studimin dhe karrierën i mbështetin të rinjtë gjatë zgjedhjes së një profesioni, një universiteti ose një karriere. Me biseda, informacione dhe testime ata u ndihmojnë atyre për të vendosur Vendet kantonale

të këshillimit ndodhen në Chur, Davos, Ilanz, Poschiavo, Roveredo, Samedan, Scuol dhe Thusis.

Amt für Berufsbildung Graubünden (Zyra e Arsimit Profesional Graubünden)

☎ 081 257 27 68

www.berufsbildung.gr.ch

Shkollat e mëtejshme dhe formimi profesional

Pas kohës së detyrueshme të shkollës nxënëset dhe nxënësit zgjedhin ndërmjet një shkolle të mëtejshme për formim të përgjithshëm ose për një mësim profesioni.

Oferta mbi zgjidhjet e ndërmjetme

Të rinj, të cilët pas mbarimit të shkollës së detyrueshme nuk kanë gjetur një vend mësimi profesional, mund të ndjekin një vit të ofruar si zgjidhje e ndërmjetme. Ky vit ndihmon për të përpunuar boshllëqet shkollore dhe për të zhvilluar një perspektivë profesionale. Informohuni për këto oferta parapra kisht tek personi mësimdhënës ose tek këshillueset për profesionin.

Të rinj të emigruar vonë

Arsimi vendos në mënyrë vendimtare mbi mundësitë e pjesëmarrjes në jetën ekonomike dhe shoqërore. Prandaj është e rëndësishme që të rinj, që kanë gjuhë amtare të huaj, të cilët e kanë kryer tanimë kohën e tyre të detyrueshme të shkollës në vendin e tyre të origjinës dhe hyjnë në Zvicër me bashkim familjar, të kenë mundësi të hyjnë në sistemin e formimit profesional.

Ofertat arsimore të orientuara posaçërisht tek nevojat e të rinjve që kanë gjuhë amtare të huaj, ofrojnë mbështetje në rrugën drejt gjetjes së një zgjidhjeje të ndërmjetme ose të një arsimit profesional. Informacion dhe këshillim për ofertat e arsimit ju gjeni tek

Informationszentrum Integration Graubünden (Qendra e informacionit për integrimin)

☎ 081 257 36 83

www.integration.gr.ch

Gjimnaze, shkolla të mesme tregtare dhe profesionale

(shkolla të formimit të përgjithshëm)

Informacione për ofertat e ndryshme ju gjeni nën

www.bks-campus.ch

www.ahb.gr.ch

Mësimi i profesionit

Vendosin vajzat dhe djemtë e rinj pas shkollës për një mësim profesioni, për shembull si zdrukthëtar, elektrikist ose rrobaqepës, qëndron mundësia, të kryejnë një mësim përkatës profesioni. Mbi bazën e një kontrate për mësimin e profesionit, nxënësit punësohen në një ndërmarrje ku mësohet, në të cilën ata kualifikohen dhe paguhen. Ata shkojnë një deri dy ditë në javë në një shkollë profesionale, në kohën e mbetur ata përveçtojnë në ndërmarrje dituri praktike. Një mësim profesioni zgjat dy deri në katër vjet dhe përfundon me një certifikatë federale për profesionin ose me një dëftesë profesionale të aftësive. Të dyja përfundimet janë të njohura në të gjithë Zvicrën.

Maturë profesionale

Matura profesionale plotëson kualifikimin profesional bazë me një formim të zgjeruar të përgjithshëm. Ajo mundëson hyrjen në një shkollë të lartë profesionale "FH". Me një provim shtesë është i mundur gjithashtu studimi në një universitet.

Formimi profesional dhe kualifikimi i mëtejshëm në pjesën terciare

Në kantonin Graubünden ka një ofertë të gjerë prej shkollash të larta profesionale, shkollash të larta dhe institute kërkimesh.

Amt für Höhere Bildung Graubünden (Zyra e Arsimit të Lartë)

☎ 081 257 61 65

www.ahb.gr.ch

Shërbimi psikologjik shkollor

Oferta e këshillimit ju përshtatet fëmijëve në kopshtet dhe në shkollat shtetërore, nëse gjatë të mësuarit shkollor, në zhvillim, në sjellje ose në gjendjen emocionale shfaqen probleme. Ky shërbim i ofrohet prindërve dhe të rinjve, personave mësimdhënës si dhe personave të tjerë të specializuar pedagogjikë në kuptim të ndihmës për vetëndihmë.

Amt für Volksschule und Sport Graubünden AVS (Zyra e Arsimit dhe Sportit)

☎ 081 257 27 41

www.av.s.gr.ch

Psikiatri për fëmijë dhe të rinj Graubünden

Nëse fëmija juaj ka probleme psikike, vështirësi me veten e tij, në familje, në sjelljen me shokët e tij ose nëse ai ka rënë në konflikt me ligjin, mund të kontaktohet: Kinder- und Jugendpsychiatrie Graubünden (Psikiatri për fëmijë dhe të rinj).

Kinder- und Jugendpsychiatrie Graubünden kjp (Psikiatri për fëmijë dhe të rinj)

☎ 058 225 19 19

www.kjp-gr.ch

Dhuna ndaj fëmijëve

Nëse një fëmijë tregon shenja të zbatimit të dhunës ndaj tij, mund të kontaktohet zyra e këshillimeve për ndihma ndaj viktimave (Beratungsstelle Opferhilfe) Graubünden për këshilla dhe mbështetje profesionale.

Beratungsstelle Opferhilfe Graubünden (Zyra e këshillimeve - ndihmë për viktimat)

☎ 081 257 31 50

www.soa.gr.ch

BANIMI

Shpallje për banesa

Shpallje për banesa ju gjeni në njoftues të rajonit tuaj, në gazetatat ditore dhe në internet. Banesa të lira ju gjeni nganjëherë gjithashtu në shpalljet e klientëve në muret e afisheve në dyqanet e mëdha për blerje, si për shembull Migros dhe Coop.

www.immoscout.ch
www.homegate.ch
www.comparis.ch
www.newhome.ch
www.suedostschweiz.ch

Në rast të interesimit për një banesë ju duhet, si rregull, të plotësoni një formular si dhe t'i dorëzoni pronarit të shtëpisë ose administratorit të pasurisë së paluajtshme dokumente, si për shembull një ekstrakt nga regjistri i përmbartimeve si dhe një leje qëndrimi.

E rëndësishme:

- Në shpallje për banesa bëhet kërkesa, qiradhënësi zgjedh qiramarrësin.
- Të merren parasysh kushtet e kontratës, si për shembull afatet e prishjes së kontratës.

- Në shtëpitë me qira ka rregullore për shtëpinë, të cilat rregullojnë jetën e përbashkët (për shembull qetësinë e natës ose përdorimin e makinës larëse).
- Çdo shtëpi me qira ka një për-kujdestare ose një për-kujdestar shtëpie e cila/i cili kujdeset për zbatimin e rregullit shtëpiak si dhe të pastërtisë rreth ndërtesës.
- Çdo banesë duhet të paguajë një kontribut për radio dhe televizor. Ju merrni faturën automatikisht nga zyra për marrjen e taksave për përdorimin e radios dhe televizorit në Zvicër (Serafe).

Serafe AG

☎ 058 201 31 67
www.serafe.ch

Informacione të tjera dhe një broshurë për temën «Banimi» – që mund të merret në 11 gjuhë – ju gjeni tek

Bundesamt für Wohnungswesen BWO (Enti Federal për Punët e Banimit)

☎ 058 480 91 11
www.bwo.admin.ch



Vendi i këshillimit për të drejtën e qirasë

Shoqata e qiramarrësve Graubünden jep informime për pyetjet rreth marrjes së një banese me qira. Ky shërbim është me detyrim pagese për jo anëtarët.

Mieterverband Graubünden (Shoqata e Qiramarrësve)

☎ 081 253 60 62

www.mieterverband.ch

Në rast konfliktesh ju mund të kontaktoni komunën tuaj për adresën e zyrës së pajtimit.

SHËNDETI

Informacione të hollësishme për temën «shëndeti» ka në portalet e internetit www.bischfit.ch dhe www.migesplus.ch. Për t'u këshilluar në mënyrë të veçantë është «Udhërrëfyese për shëndetin», i cili është në gjuhë të ndryshme.

www.bischfit.ch
www.migesplus.ch

Adresa të mjekeve dhe mjekëve

Në çdo libër telefoni ju gjeni adresat të mjekeve dhe mjekëve praktikues/e në rajonin tuaj.

Sëmundje ose aksidente

Në Zvicër është e zakonshme, të kesh një mjeke shtëpie ose një mjek shtëpie, e cila ose i cili është personi i parë që i drejtohesh në rast sëmundjesh. Nëse ju nuk mund ta arrini në telefon mjekun ose mjeken tuaj të shtëpisë, dëgjoni në sekretarinë e telefonit numrin e telefonit të një zëvendësuesi ose të mjekut të shërbimit respektivisht të mjekes së shërbimit. Shërbimi emergjent i spitalit në afërsinë tuaj mund të kontaktohet po ashtu për informime.

Në rast të ndihmës së menjë-

hershme merrni në telefon

Numri i emergjencës i sanitetit

☎ 144

Rast emergjent, si veprohet?

shih kapitullin 21, faqen 64

Spitali

Në rast të problemeve shëndetësore, të cilat kërkojnë kontrolle të hollësishme, trajtime ose një operacion, mjekja juaj familjare ose mjeku juaj familjar ju dërgon tek një mjeke specialiste ose mjek specialist ose në një spital. Informohuni tek sigurimi juaj shëndetësor se në cilat spitale mund të trajtoheni.

Këshillim dhe përkujdesje në shtëpi

Nëse ju për shkak të sëmundjes ose aksidentit jeni i/e varur nga një mbështetje në punët shtëpiake, mund t'i drejtoheni Spitex-it në komunën e banimit tuaj.

Spitex Graubünden

☎ 081 252 77 22

www.spitexgr.ch

Persona të moshuar

Tek «Pro Senectute» njerëz të moshuar marrin këshilla dhe mbështetje si dhe në rast nevojë edhe përkujdesje në shtëpi

Pro Senectute Graubünden

☎ 081 252 75 83

www.gr.prosenectute.ch

Njerëz me aftësi të kufizuara

